



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

---

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË  
BASHKISË SHKODËR ”.

**Konsultim publik :** *Banoret e Nj. Administrative Guri i Zi*

**Data :** 21.10.2021

**Ora :** 13.00

**Vendi:** Nj.Administrative Guri i Zi

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesëmarrësve 35, nga të cilat 7gra dhe vajza.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Per draft projekt planin buxhetor afatmesem 2022-2024 të bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Kryetare e bashkisë znj. Voltana Ademi, Administrator i Nj.Administrative Pjerin Marku, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadija, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Drejtor i Drejtorise se Bujqesise Alban Sekja, Drejtor i Drejtorise Ekonomike të Arsimit Zj.Aulida Anamali, përfaqësues të drejtorive përkatëse të bashkisë Shkodër, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

**Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetare e Bashkisë dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilat bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtruan pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :**

**I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL**

**1. Z.Genti Pjetri: Drejtor i shkollës Zef Jubani.**

- a. Kërkesa ime është për arsimin parashkollor. Dy kërkesa kam për shkollën që unë drejtoj. Ju falenderoj që vitet e fundit kena pas mbështetje nga ana e bashkisë, pasi është bërë suvatimi, dhe instalimi elektrik i ambjenteve që kanë pasur nevojë.

- a) Mendojmë se duhet të hapet një klasë kopshti në shkollën tonë mëqënëse kena edhe ambientet të disponueshme. Ia bashkengjis kësaj kërkesë edhe mirëmbajtjen kopshtit.
- b) Kërkoj një terren sportive. Jemi shkolla e dyte në NJ.Administrative për nga numri i nxënësve. Te krijohet mundësia për një fushë të rregullt sportive, basketbolli ose futbolla, sipas mundësisë që na lejon buxheti.

## **2. Znj.Ejrsi Rripaj, Drejtoreshë kopshti**

- a. Ne e kemi marrë kërkesën për hapjen e kopshtit. Është e domosdoshme hapja e kopshtit në këtë shkollë. Kemi marrë firmat e prinderve. Me dëshirë të madhe mendojmë se duhet të bëjmë të mundur hapjen e shkolles. Mendojme se në vitin 2022 duhet të planifikohet.

## **3. Znj.Mirela Pjetrani, Drejtoreshë e gjimnazit “At Zef Karma” Guri i Zi**

Propozoj:

- b. Praninë e një roje në ambientin e shkollës.
- c. Shtoj kërkesën për një sekretare në shkollë, sepse sasia e dokumentacionit që prodhohet nga shkolla është shumë madhe.
- d. Stafi i punonjësve që janë për mirëmbajtjen e shkollës, të jenë më present në shkollë dhe të përgjigjen në kohë për nevojat që ka shkolla. Unë kam një shkollë me 400 nxënës. Roli im është që të informoj mbi problemet që paraqiten në ambientet e shkollës. Kërkoj që problematikat të zgjidhen në kohë.

## **4. Znj.Armela Vata edukatore në Kuç:**

- a. Në fshatin Kuç janë bërë investime në kopsht. E vetmja gjë që mungon është një rrethim i oborrit të kopshtit. Kemi problem me sigurinë sepse kopshti është ngjitur me rrugën.

## **5. Z.Ardian Beqiri, Drejtor shkolle në Rragam**

Propozoj:

- b. Lyerjen e ambjenteve të klasave të shkollës.
- c. Para dy viteve kam bërë një kërkesë për një kopësht, por nuk është miratuar. Të shikohet mundësia e hapjes së një kopështi.
- d. Tek aneksi Shëldi sistemi i ngrohjes është me kaldajë me gaz. Sistemi i gazit është vendosur jashtë ambientit të shkollës. Kërkojmë që të mos ndrrohet bombula, por mbushja me gaz të bëhet tek e njëjta bombël.

## **6. Z.Kujtim Toka, Kryetar i fshatit Kuç**

- a. Më vjen mirë që organizohen takime të tilla, shërbejnë për të evidentuar problemet që dalin, dhe për ti dhënë një zgjidhje.
- b. Kërkoj që të investohet tek shkolla e Kuçit pasi është tejet e amortizuar.

**7. Znj. Ermira Beqiri, Edukatore në Vukatanë.**

- a. Fshati është fshat i madh dhe ka shumë fëmijë. Siperfaqet e klasave janë shumë të vogla.

propozoj:

- a. Shtim ambjenti kopështi për fëmijë (35 fëmijë në kopësht)  
b. Kërkojmë rrethimin e oborrit.  
c. Kërkojmë kënd lojrash për fëmijë

**8. Z.Alfred Haxhari, Agronom**

- a. Shkolla e Vukatanës ka rrethim, me ba rrethim brënda rrethimit nuk më duket gjë normale.  
b. Drejtorët e shkollave duhet të kërkojnë kënde lojrash, biblioteka dhe mjete didaktike për fëmijë.  
c. Ujësjellësi është emergjencë dhe duhet zgjidhur.

**9. Z.Gent Pjetri, Shkolla Zef Jubani**

- a. Na kanë ardhë nga ZVA librat që duhen për arsimin e mesëm dhe arsimin bazë. Kemi nevojë për të pasur më shumë libra.  
b. Uji e pijshëm është problem. Në shkollë, kemi ujë të vazhdueshëm, dhe shfrytezojmë ujin. Uji nuk është i pijshëm por ne e konsumojmë për tu pirë.

**II: MENAXHIMI I MBETJEVE**

**Znj.Voltana Ademi:** - Si është shërbimi? A kemi nevojë për të shtuar kontinjerë? A kemi nevojë për të shtuar frekuencën? A kemi nevojë për të shtuar pika grumbullimi mbetjesh?

**1. Z.Pjerin Marku, Administrator i Nj.Guri i ZI: Menaxhimi i mbetjeve nuk është aq prefekt.**

- a. Kemi nevojë që të ndërtojmë xhepat në vijim  
b. Kemi nevojë që të zëvendësojmë kontinjerë.  
c. Të bëhet heqja e kontinjerëve të vjetër që janë jashtë shërbimi . Kam përshtypjen se kontinjerët e vjetër duhet të dalin jashtë funksioni.  
d. Frekuencën e pastrimit duhet ta ndryshojmë. Të ndryshohet dita e pastrimit. Ose të bëhen të ditën e Diele paradite , ose ditën e Premte.  
e. Në mënyrë që të funksionojë shërbimi i pastrimit, kërkoj që frekuenca të bëhet më shpesh.

**2. Z.Kolë Marku, banor i fshtit Rrencë**

- a. Propozoj që të shtohen konteinerë përgjatë rrugës së re tek lapidari.

**3. Z. Tonin Rroku, Kryetar i fshatit Guri i Zi**

- a. Është bërë një punë e mirë më shtrimin e rrugëve. Këto rrugë të reja që janë bërë kanë nevojë për kontinjerë.
- b. Tek Qendra Shëndetësore, janë konteiner të amortizuar. Duhet të hiqen.

**4. Z. Ndoc Shporaj, fshati Shpor.**

- a. Ne nuk depozitojmë mbetje në njësinë Guri i Zi. Pse duhet të paguajmë taksë pastrami kur nuk marrim shërbim?

**III: NDRICIMI RRUGOR**

**1. Z.Tonin Rroku, banor i fshatit Guri i Zi**

- a. Përsa i përket ndricimit; Tek rrugët e reja që janë bërë kërkojmë furnizim me bazë material sepse gjithë punët e realizojmë vetë.

**2. Z.Bari Osmani, banor i fshatit Vukatë**

- a. Ne kemi nevojë për të shtuar llampa. Ka shtylla, duhet shtohen vetëm ndricues ( bëhet fjalë për 23 ndricues të rinj).

**3. Z. Gjon Pjetri, fshati Rrencë**

- a. Kërkojmë që të vendosen edhe 3 ndricues në fshatin Rrencë.

**4. Z.Shefqet Muçi, banor i fshatit Rragam**

- a. Janë vendosur ndriçues në fshatin tonë, por kërkojmë që të shtohen përsëri Shtyllat janë (Bëhet fjalë për vendosjen e 15 ndriçuesve).

**5. Z.Kujtim Toka**

- a. Rruga e fshatit Kuç është ndër rrugët më të mira. Duhet 3-4 shtylla për ndriçim, dhe plotësohet plotësisht ndriçimi i rrugës në fshatin Kuç.
- b. Kemi rrugën e Grenasit nga kabina elektrike, me duket se është vendosur si prioritet për buxhetin e vitit 2022. Duhet të mendohet që të bëhet edhe ndriçimi për këtë rrugë.

**6. Z. Jozef Ndoci, banorë i fshatit Juban**

- a. Qendra e fshatit Juban ka nevojë për ndriçim. Janë 20 shtylla që duhen të plotësohen me ndriçim.

**7. Z.Hilmi Meti, fshati Juban, Lagjia Ferracakej**

- a. Nuk kemi ujë të pishëm, nuk kemi ujë me vadit.
- b. Rruga e Ferracakeve ka 75 shtëpi, është një rrugë tejet e amortizuar. Kërkojmë që të asfaltohet.

### **8. Z.Kolë Marku, fshati Rrencë**

- a. Kërkoj që të bëhet edhe investimi i ndriçimit në rrugët e reja që janë rregulluar.

## **IV: SHERBIMI i KULLIMIT**

### **1. Z. Shefqet Muça, banor i fshatit Rragam**

propozoj:

- b. Që të pastrohet vija e pistallit
- c. Të investohet në vaditje

- 2. Znj.Voltana Ademi:-** Shërbimi i vaditjes ka kosto të lartë. Gjithe investimet të kësaj natyre bëhen : bashkëpunim me qeverinë.Kush e ka rradhën për të investuar në shërbimin e vaditjes dhe në kullim?

### **3. Z.Petrit Dyli, banor i fshatit Guri i Zi**

Propozoj:

- a. Rikontruksionin e kanalit vadites të sipërm dhe rikontruksion i kanalit vaditës të poshtëm (6 km)
- b. Gjatë sezonit veror e shoh të rëndësishëm punësimin e një punonjës për mirëmbajtjen e këtyre kanaleve.
- c. Kanali i Gurit të Zi është funksional, ka dy vite që është investuar. Ka nevojë për merimetim.
- d. Unë nuk marr ujë nga kanali direkt. Unë marr ujë nga pusi. Të gjithë që janë nën kuotën e kanalit duhet të pagujnë një tarifë.

- 4. Znj.Voltana Ademi:** A vlen propozimi që të paguajmë më shumë, në mënyrë që të rrisim : për mirëmbajtjen e kanaleve (tarifë 1000 lekë në vit).

- 5. Z.Alban Sekja:** - Është përlloraritë minimumi në vaditje për të gjithë kulturat ( 2000 lekë në vit). Paratë që grumbullohen do të shkojnë për mirëmbajtjen e kanaleve ekzistuese, dhe për të meremetu difektet. Ku kemi nevojë për ndërhyrje kanalesh për vitin në vazhdim?

### **6. Z. Jozef Ndoci**

- a. Pagesa e tarifës për investimet në kanale, duhet që të fillojë që të paguhet nga fermerët me Nipt fermeri. Nuk jam dakord që të paguhet për familjet me ndihmë ekonomike ose shume të varfëra.

- b. Nje kanal kryesor KK2 (pritet të hapet nga bordi i kullimit). Nuk janë hapur disa kk2 në fshatin Juban. Janë rreth 2.3 km i cili kai nevojë të pastrohet.

**7. Z.Arjan Gjura, banor i fshatit Juban**

- a. Mendoj që tarifa për mirëmbajtjen e kanaleve duhet vendosur sipas sipërfaqeve të tokës që ka gjithësecili nga fermerët.

**8. Z.Zef Kçira, banor i fshatit Gajtan**

- b. Unë jetoj në fillim të kanalit. Saracineksa e kanalit furnizues ka nevojë për një rregullator mirëmbajtës.

**9. Z.Bahri Osmani, banorë i fshatit Vukatanë.**

- a. Përsa i përket kanaleve të kullimi, është bërë një punë e mire në gjysmën e fshatit. Presim që të investohet edhe në pjesën tjetër që ka mbetur.
- b. Përsa i përket kanaleve vaditëse, ka 30 vite që nuk investohet. Të shikohet mundësia që të investohet edhe në kanale vaditëse.

**10. Z.Alban Sekja: -** Ne kemi dy mjete për pastrimin e kanaleve kulluese. Po bëhet punë e mire. Kanalet duhet pastruar një herë në tre vite. Në vitin e ardhshëm do të duhet të vijmë përsëri për të pastruar kanalet kulluese në Gurin e Zi.

Përsa i përket një kanali në fshatin Juban, që pretendohet se është kanal i dytë, e kemi diskutuar me Bordin e Kullimit për ndihmë.

Ligji parashikon, takse mirëmbaje kanalesh kulluese e vaditëse. Ne mendojmë që të vendosim vetëm tarifën e shfrytëzimit të ujit.

**11. Z. Gjon Pjetri, banor i fshatit Rrenc:**

- a. Toka ime është e bllokuar nga prurjet që vijnë nga lart. Se di si mund të disiplinohen këto ujra sepse tokat po na shkojnë dëm.
- b. Kërkoj një ekskavator që të realizojë pastrimin, sepse kanë kaluar prurjet mbi nivelin e tokës.

**12. Z.Isak Bajrami, banor i fshatit Vukatanë**

- a. Është bërë punë goxha e mirë përse i përket pastrimit të kanaleve kolluese, por nuk është mjaftueshëm. Kanalet kolluese duhet pastrohen për çdo vit.
- b. Çdo person duhet të paguajë që ti pastrohen kanalet nga bashkia.
- c. Duhet përshpejtuar regjistrimi i tokave, dhe tarifa të vendoset sipas gjatësisë së kanalit që duhet pastruar.

**13. Z.Gjovalin Bardeli, banor i fshatit Rrencë**

- a. Bujqesia është jashtzakonisht e rëndësishme për zonën tonë. Gjithçka që kemi, e kemi të lidhur me tokën.

- b. A ka menduar bashkia Shkoder, për futjen e metodave bashkohore për ofrime shërbimesh. Shof me dhjetra punetore duke prerë punëtore aneës rrugës.
- c. A mund të ndërhyje bashkia me institucione të tjera që të japë kredi me ble një zetar.
- d. Jemi duke punuar tokën, por toka nuk asht e jona. Duhet të kryhet procesi që të bëhemi me tapiat e tokave. Është shumë e rëndësishme sepse një shtet i konsolidum vjen duke pasur një pronë të konsolidume.
- e. Kanë filluar me na i zaptu pronat e komunitetit në fshat. Shikoni mire disa probleme. Vijnë nga Puka, dhe zaptojnë pronat tona. Nuk e di kujt ti drejtohem, nuk është mirë që sot të ballafaqohena me njerezit kur shteti është funksional.

## **12. Z.Kujtim Toka**

- a. U diskutu problemi i kanaleve. Është shumë i rëndësishëm investimi në kanalin kryesor. Me këtë kanal laget fshatrat Juban, Vukatan dhe Kuc. Duhet verifikuar ky kanal sepse i shërben nje komuniteti të madh. Mendoj se është një investim i realizueshëm sepse është kanal ekzistues.
- b. Kanalet Kulluese janë bërë goxha mirë. Janë pastruar 60-70% KK2 dhe K3.

## **V: RRJETI RRUGOR RURAL**

### **1. Z.Ndrek Gega, banor i fshatit Juban:**

- a. Është emergjencë ndërhyrja në kanalin që tha Jozef Ndoci. Ska problem më të madh në atë vend.
- b. Kërkoj që të shtrohet trotuari përgjat rrugës nacionale, si dhe të vendoset një bum.

### **2. Z. Gjon Pjetri, banor i fshatit Rrenc.**

- a. Investimet në fshatin Rrenc jane të pakta. Kërkoj të investohet në rrugën që lidh fshatin Rrenc – Bardhaj.

### **3. Z.Arjan Shporaj, banor i fshatit Mazrek**

- a. Çdo njëri nga ne kërkon investime në zonen e vet, por mendoj që gjithësecili nga ne duhet të kontribojë edhe me pagesen e taksave dhe tarifave. Bashkia duhet të jetë më agresive përse i përket vjeljes së taksave.
- b. Qëllimi kryesor që unë erdha këtu është nevoja e lagjes ku unë jetoj. Kërkoj që rruga e fshatit Mazrreku, pranë kishës, të shtrohet me çakull.
- c. Përsa i përket Turizmit, kemi shumë resurse natyrore që mund të shfrytëzohen. Duhet investuar në shumë rrugë për ti dhënë mundësinë e shfrytëzimit këtyre bukurive që ka vendi jonë.
- d. Është hapur një rrugë në fshatin Mazrek me forcat e vet banorëve. Kërkoj disa makina çakull për të shtruar tek rruget e hapura ne fshatin Mazrek. Në fshatin Mazrek është dhe

nje kishë, ku me shume pak investim kjo rrugë bëhet e kalueshme (Rruga nga ishulli i Sardes-tek kisha ne Mazrek)

**4. Z.Frederik Marku, banor i fshatit Ganjolle.**

- a. Në fshatin Ganjoll janë shtruar disa rrugë. Kërkoj që të shtrohet një rrugë në lagjen time. Është një rrugë e veshirë ( 150 metra rrugë)

**5. Z.Petrît Dyli:**

- a. Propozoj që të shtrohet rruga e varrezave myslimane në fshatin Gurin e Zi. Aty kalojnë dy lagje (rruga 1 km e gjatë).
- b. Propozoj shtrimin e rrugës “Nënë Tereza” në fshatin Juban. Kërkoj që të vendosen edhe dy bume sepse është një segmen që ka marre jetë njerëzish.
- c. Kërkoj që rruga e fshatit Rrencë të shtrohet deri ne fshatin Bardhaj.

**6. Z.Isak Bajram:**

Kërkoj:

- a. Riparimin e rrugës nga Vukatana-Shkodër
- b. Rregullimin e rrugës nga Çinari i Jubanit deri në Suken e Ferracakve
- c. Rregullimin e rrugës nga Hekurudha - kodër:

**7. Z.Adem Alija, banorë i fshatit Kuç**

- a. Kërkoj që të shtrohet rruga e Grenasit. Në qoftëse ju e planifikoni për të investuar në këtë rrugë jemi gati që të financojmë për shtrimin e kësaj rruge ( 850m Rrugë).

**8. Z.Shefqet..**

- a. Kërkoj që të hapet rruga e malit. Nevojitet vetëm një mjet (fadromë ) për ta bërë të mundur hapjen e rrugës. Është një rrugë që shërbën edhe për mnjetet e zjarfikësve në kohën kur bie zjarr në mal.

**VI: KUJDESI SHENDETESOR**

**1. Z. Edmond Bungaja, Drejtor i Qendrës Shëndetësore Guri i zi**

- a. Aktualisht shërbimi shëndetësor shërbehet në ambulancat e Rrencit, Kuçit, Vukatanës, Jubanit , Guri të Zi, Ganjollë dhe Rragam.
- b. Kemi kërkuar riparimin e Ambulancës së Rragamit, por nuk na është realizu investimi. Riparimi i këtyre ambinteve është bërë nga ana jonë, duke bërë riparimin e dritareve dhe kanaleve kulluese rreth ndërtesës.
- c. Që nga periudha e fillimit e marsit 2020, Ambulanca e Gurit të Zi ka ofruar shërbim për 30 - 50 persona. Në këtë ambulancë është problem hapsira e shërbimit. Sipërfaqja nuk është



më shumë se 150m<sup>2</sup>. Kemi konvertuar korridoret në salla pritjeje, recepsionin për testim dhe vaksinimin e përsoneve. Sipërfaqja është shumë e vogël për të realizu shërbimin.

- d. Janë riparuar 5 ambulanca me fondet tona minimaliste.
- e. Kërkojmë riparimin e çatisë së ambulancës së Rragamit(është prioritet për ne).

Për të gjithë pjesemarresit u shpërndanë fletë vlerësimi përmes plotësimit të të cilave u shprehen se cilët rrugë janë ato prioritare për të rregulluar apo rehabilituar. Propozimet janë listuar më poshtë:

- f. Rr. Logorec- Ferracak
- g. Rr. Grenas-Lumin Drin
- h. Trotuari nga Nen Tereza -Shkolla Zef Jubani
- a. Rr. Varrezave Myslimane
- b. 5.Rr. Nene Tereza -Rr. Ferracakve
- c. 6.Trotuari ne qender te Gurit Te Zi
- d. 7.Rregullim i dy rrugeve ne qender te Gurit te Zi
- e. Loti II RR.Lameve
- f. RR. Grenasit ne Kuç
- g. Loti III Vukatane-Guri i Kuç

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajti procesverbalin

Fisnik Lutfija.

---







Këshilli i me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmorfëm 2022-2024  
Nj. Administrative Curi 1 Zi

| NR | EMER    | MBIEMER | GUJIA | MOSHA | VENDBANIMI<br>(FSHATI) | PROFESIONI     | PUNESIMI      |
|----|---------|---------|-------|-------|------------------------|----------------|---------------|
| 01 | Mirë    | Fishta  | M     | 50    | KUS                    | Profesionalist |               |
| 02 | Emvato  | Simoni  | F     | 28    | RRITË                  | Specialist     | 211           |
| 03 | Konçhin | Tolca   | M     | 59    | Kuç                    | Engje          | prof.         |
| 04 | Erdit   | Sokol   | M     | 33    | Shkodër                | Ing. Kukur     | Prof. Shkollë |
| 05 | Smolca  | Abduri  | F     | 58    | Shkodër                | Edmond         | Komandant     |
| 06 | Shpota  | Bullku  | F     | 59    | Shkodër                | Ins. Shkodër   | Prof. Shkodër |
| 07 | Artan   | S.Ç.    | M     | 34    | Gjini                  | Ins. Shkodër   | Prof. Shkodër |
| 08 | Edmond  | Proçp   | M     | 35    | Shkodër                | Prof. Shkodër  | Prof. Shkodër |
| 09 | Shekaf  | Abduri  | M     | 53    | Prizren                | Prof. Shkodër  | Prof. Shkodër |
| 10 | Marin   | A.Çika  | M     | 47    | Prizren                | Prof. Shkodër  | Prof. Shkodër |
| 11 | Armen   | Shkollë | M     | 42    | Prizren                | Prof. Shkodër  | Prof. Shkodër |
| 12 | Andri   | Proçp   | M     | 47    | Prizren                | Prof. Shkodër  | Prof. Shkodër |
| 13 | Bohna   | Osman   | M     | 53    | Prizren                | Prof. Shkodër  | Prof. Shkodër |

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

| NR | EMER            | MBIEMER       | GJINIA | MOSHA | VENDBANIMI<br>(FSHATI) | PROFESIONI          | PUNESIMI                     |
|----|-----------------|---------------|--------|-------|------------------------|---------------------|------------------------------|
| 1  | Mdoc            | Dimori        | M      | 52    | Guri Zi                | Rikter              | Bashkia                      |
| 2  | Mela            | Shparyq       | M.     | 52    | Shpote                 | Mentor              | Kompani<br>Prorege<br>shtet. |
| 3  | Spomali         | Isanobeli     | M      | 55    | RRece                  | ambulator           |                              |
| 4  | Ulmeri.         | Geqa          | M.     | 66    | Yllhami                | Pemron              |                              |
| 5  | Trakocil        | Mshkic        | M      | 58    | Nganjell               | mentore             |                              |
| 6  | Gendi           | Petri         | M.     | 47    | Shkoder                | Dr. Shkoll          | Dovson                       |
| 7  | Petrit<br>Hotaj | Dylli<br>Mbes | M      | 47    | Guri Zi<br>Mshon       | hidraulik<br>Madrin | Bashkia<br>D. Shkoll         |
| 8  | Alfred H        | Hoxhami       | M      | 60    | Guri Zi                | Aronov              | AKTAR Pr.                    |
| 9  | Prete           | Canuf         | M      | 59    | Shkoder                | Ketunues            | Bashkia                      |
| 10 | M-shok          | Dajvan        | M      | 66    | Ukatani                | D. shk              | Penshon                      |
|    | Ridvor          | Guri          | M      | 56    | Shkoder                | riudues             | Penshon                      |
|    | Repaal          | Amstey        | M      | 36    | Repaam                 | histologji          | Bashkia                      |

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

| NR | EMER    | MBIEMER | GUINIA | MOSHA | VENDBANIMI<br>(FSHATI) | PROFESIONI    | PUNESIMI    |
|----|---------|---------|--------|-------|------------------------|---------------|-------------|
|    | Byrrza  | Q. Jeta | M      | 71    | Brada                  | Permat        | Permat      |
|    | Taqir   | Reber   | M      | 56    | Cukri Zi               | P. Pun        |             |
|    | Dele    | Yorha   | M      | 54    | Reber                  | P. Pun        | Q. Jeta     |
|    | Rolond  | Zhola   | M      | 31    | Guri Zi                | rektoriside   | rektoriside |
|    | Angela  | Zel     | F      | 28    | Ponc                   | Yunist        | Yunist      |
|    | Milinda | Q. Jeta | F      | 45    | Y. Reber               | Udhëzues      | Udhëzues    |
|    | Ejri    | Reber   | F      | 42    | Y. Reber               | Dyktor        | Dyktor      |
|    | Armela  | Vate    | F      | 32    | S. Keshen              | Edukatore     | Edukatore   |
|    | Picula  | Marku   | M      | 52    | G. Jeta                | Administrator | B. Shkodër  |
|    |         |         |        |       |                        |               |             |
|    |         |         |        |       |                        |               |             |
|    |         |         |        |       |                        |               |             |
|    |         |         |        |       |                        |               |             |

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK \_\_\_\_\_